



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë /
Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate



RAPORTI VJETOR I PUNËS I POLICISË SË KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2021

- www.kosvopolice.com
- www.facebook.com/KosovoPolice
- twitter.com/Kosovo_Police
- info@kosvopolice.com
- Aplikacioni lajmëro Policinë
- 192

- Titulli i raportit: **Raporti vjetor i punës i Policisë së Kosovës
Janar - Dhjetor 2021**
- Përpiluesi: **Toger Fahrije LUTFIU**
Sektori për Planifikim Strategjik,
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
- Mbikëqyrur: **Major Sadik SHEFQETI**
Zëvendësues i Shefit të Sektorit për Planifikim Strategjik, Drejtoria për Planifikim Strategjik
dhe Çështje Ligjore
- Aprovon: **Kolonel Riza SHILLOVA**
Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
- z. Dejan JANKOVIĆ**
Zëvendës drejtor i përgjithshëm i Policisë për Resurse
- Autorizon: **z. Samedin MEHMETI**
Drejtor i përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës
- Lektor: **Merita CANOLLI-GASHI**
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
- Përkthim në gjuhën angleze dhe serbe: **Sektori i përkthimeve**
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
- Dizajni grafik: **z. Çajup KAJTAZI**
Webdizajner
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Policia e Republikës së Kosovës
www.kosovopolice.com

☎ 192

✉ info@kosovopolice.com

RAPORTI VJETOR I PUNËS I POLICISË SË KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2021




TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
PARANDALIMI I PËRHAPJES SË KORONAVIRUSIT 'COVID-19'	8
SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE.....	10
SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR.....	12
PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE E RËNDA, KRIMIT EKONOMIK&KORRUPSIONI, TERRORIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT.....	14
KONTROLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT.....	17
NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE.....	18

LISTA E SHKURTESAVE

BIMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DShSh	Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
KA	Komisioni i Ankesave
KBD	Komisioni i Brendshëm Disiplinor
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
PK	Policia e Kosovës
PRIMS	Sistemi informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë së Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QKTGj	Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut
QS	Qendra Studentore
SIPK	Sistemi i Integruar Informativ i Policisë së Kosovës
SHGPK	Shoqata e Grave e Policisë së Kosovës
UD	Ushtruesi i detyrës
UO	Urdhër Operativ

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë



z. Samedin MEHMETI

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

Kam kënaqësinë të paraqes raportin vjetor të punës së Policisë së Kosovës për vitin 2021, në të cilin janë paraqitur rezultatet dhe të arriturat e punës sonë, sfidat, analizat, si dhe identifikimi i fushave të caktuara ku nevojitet shtimi i angazhimeve tona.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport na ndihmojnë të bëjmë analizat e nevojshme, për të kuptuar sfidat dhe nevojat se ku duhet të rrisim kapacitetet njerëzore dhe teknike, si dhe planifikimet që duhet bërë në mënyrë që të ulim sa më shumë që të jetë e mundur nivelin i krimit dhe të ofrojmë një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim.

Fatkeqësisht edhe këtë vit kemi punuar në kushte pandemie nga virusi COVID -19, duke u përballur me vështirësitë që ka sjellë kjo situatë për tërë shoqërinë dhe institucionet e vendit, përfshirë edhe vet organizatën tonë, ku përveç që kemi qenë të angazhuar me detyra shtesë, personeli ynë ka qenë i atakuar gjithashtu nga virusi. Kjo gjendje ka bërë që të ballafaqohemi me mungesë personeli policorë, megjithatë, falë përkushtimit, organizimit dhe gatishmërisë për shërbim, ia kemi dalë suksesshëm të kryejmë detyrat që kemi marrë nga autoritetet qendrore, si pjesë e zingjirit ndërinstitucional në luftimin dhe parandalimin e COVID-19.

Meqë edhe këtë vit jemi sfiduar nga pandemia e shkaktuar nga virusi 'corona', me gjithë vështirësitë që kemi hasur, ne jemi munduar që me tërë kapacitetet e mundshme të angazhohemi në të gjitha detyrat e tjera primare sipas mandatit ligjor, në ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit tonë.

Në këtë raport vjetor ne shohim të arriturat tona, rezultatet, sfidat, nevojat dhe planifikimet që duhet bërë për avancimin dhe shtimin e aktiviteteve në resorë të caktuar, në arritjen e synimeve dhe objektivave tona, me qëllim të ngritjes së performancës së Policisë së Kosovës.

Duke qenë se edhe viti i kaluar ka qenë vit që është punuar dhe vepruar nën masat e ndërmarrja për shkak të

COVID -19, statistikatat dhe të dhënat e këtij raporti i kemi krahasuar edhe me vitin 2019, si vit i zakonshëm, ku në statistikatat e raportit të këtij viti ne shohim se kemi një ngritje të rasteve të përgjithshme, mirëpo kemi shënuar një rënie të veprave penale, përfshirë këtu zvogëlimin e numrit të vjedhjeve dhe grabitjeve, ndërsa që është rritur raportimi i rasteve të dhunës në familje.

Sfidë ende mbetet siguria në trafikun rrugor, ku Policia e Kosovës ka qenë e angazhuar në vazhdimësi me veprime proaktive dhe reaktive, fushata senzibilizuese, bashkëpunime me institucione relevante dhe akterë të tjerë. Duke qenë të vetëdijshëm se siguria në trafikun rrugor, si dhe organizimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të rregullt dhe funksional të komunikacionit rrugor kërkon një qasje multi - disiplinare, ne do të angazhohemi dhe do të ndërmarrim të gjitha veprimet sipas kompetencave dhe autorizimeve dhe në të njëjtën kohë do të nxisim edhe institucionet e tjera duke ofruar bashkëpunimin e plotë, sepse vetëm me një angazhim të përbashkët, pa dyshim që do të shënojmë rezultatet e dëshiruara.

Për këtë vit vlen të përmendet vazhdimi i aktiviteteve policore në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, ku gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete hetimore, operacione dhe arrestime të ndryshme, e për t'u theksuar është goditja e 49 grupeve kriminale.

Sa i përket fushës së Policisë Kufitare, është treguar një përkushtim i veçantë në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, luftimin e kontrabandës, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve.

Gjatë vitit 2021 gjithashtu kemi qenë të përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, trajnimin e personelit dhe zhvillimin e vazhdueshëm përmes programeve adekuate profesionale.

Në këtë vit, radhëve të Policisë së Kosovës i është shtuar gjenerata e 56-të, ndërsa jemi në proces të rekrutimit për kandidatë të rinj për policë, që kësaj radhe për herë të parë, aplikimi i kandidatëve është realizuar online, me çka është lehtësuar aplikimi për vetë aplikantët, si dhe është lehtësuar edhe puna e personelit policorë të kyçur në proces. Po ashtu, vlen të theksohet se edhe testimi me shkrim është në përgatitje e sipër dhe do të zhvillohet online.

Krahas të gjitha të arriturave, rezultateve dhe sfidave që kemi para nesh, dua të shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin tim, si dhe mbështetjen e pa rezervë për punën e palodhshme të pjesëtarëve të Policisë, të cilët janë duke dhënë kontributin e tyre të vazhdueshëm në rrugëtimin tonë të përbashkët.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 9,079 punonjës, prej të cilëve 8,113 janë zyrtarë policorë, ndërsa 966 staf civil. 85.04% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 14.96% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.82% janë shqiptarë, ndërsa 15.18% iu takojnë komuniteteve të tjera.

Numri i veprave penale të raportuara ka shënuar ngritje për 9.86%.

Numri i personave të arrestuar ka shënuar ngritje për 12.93%.

Aksidentet në trafikun rrugor kanë shënuar ngritje për 53.41%

Persona të vdekur në aksidentet e trafikun rrugor kanë shënuar ngritje për 37.03%

Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje për 17.54%.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19 brenda Policisë, përmes Drejtorisë së saj për Shërbime Shëndetësore (DShSh), janë zhvilluar një numër i aktiviteteve vetëdijesuese lidhur me parandalimin e përhapjes së virusit brenda Policisë, me ç'rast janë vendosur dhe shpërndarë posterët: *“Kur të jetë radha jote vaksinohu”, “Ndalohet hyrja pa maska” dhe “Thuaj STOP kancerit të gjirit”*.

Në zbatimin e UO për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19, janë angazhuar gjithsej 6500 zyrtarë policorë apo 80.11% e personelit të uniformuar të Policisë, në aktivitetet si në vazhdim:

- Patrullimin parandalues 24/7, fillimisht me 2 ndërrime, në orarin 12 orësh;
- 167,821 pika të kontrollit
- Në inspektimin e 20,634 qytetarëve të cilët gjendeshin në vetizolim në shtëpi;
- 3,993 përcjellje policore;
- 5,046 asistime inspektorëve komunalë, si dhe
- 1,136 asistime të shërbimeve shëndetësore.

Për mosveprim sipas dispozitave ligjore gjatë menaxhimit me pandeminë, Policia e Kosovës:

- Ka shqiptuar 199,198 fletëparaqitje në bazë të Ligjit nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës;
- Ka dhënë 50,058 vërejtje për qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë shpërndarë:

- 37,396 maska mbrojtëse kundër virusit;
- 27,698 copë dezinfektues.

Përkundër angazhimit të madh në parandalimin e përhapjes së virusit, në Polici, brenda kësaj periudhe raportuese janë infektuar 917 zyrtarë policorë me virusin COVID-19, prej tyre 12 punonjës të Policisë kanë vdekur, 1,589 punonjës të Policisë kanë qenë në vetizolim.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 108 operacione, 269 patrullime të përbashkëta, janë realizuar 55 raste të bashkëpunimit ndërkombëtar, 7,436 refuzime të hyrjes dhe 635 refuzime të daljes nga Republika e Kosovës. Janë shqiptuar 1,213 gjopa në fushën e qëndrimit ilegal dhe mos vazhdimin e lejes së qëndrimit.

Policia e Kosovës është vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 1,633 komunikata, janë publikuar 1,619 aktivitete policore, 365 raporte 24-orësh; revista e Policisë “Mbrojtësi”, si dhe aplikacioni i Policisë “Lajmëro Policinë”

Sa i përket vaksinimit kundër virusit COVID-19, brenda kësaj periudhe kohore, janë vaksinuar 8,909 pjesëtarë të Policisë, të cilët kanë aplikuar për termin të vaksinimit, nëpërmes platformës eKosova. Policia ka mbështetur edhe fushatën e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut me 1,075 dhurues vullnetarë të gjakut.



Raste	
Viti 2020	Viti 2021
40,759	50,148



Vepra penale	
Viti 2020	Viti 2021
27,404	30,108



Persona të arrestuar	
Viti 2020	Viti 2021
13,661	15,428



Persona të ndaluar	
Viti 2020	Viti 2021
4,780	5,540



Grupe kriminale të goditura	
Viti 2020	Viti 2021
28	49



Armë zjarri të konfiskuara	
Viti 2020	Viti 2021
1,135	1,280



Municione të konfiskuara	
Viti 2020	Viti 2021
32,747	42,031



Persona të vdekur në trafikun rrugor	
Viti 2020	Viti 2021
81	111



Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor	
Viti 2020	Viti 2021
256,510	484,138



Gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit	
Viti 2020	Viti 2021
611	1,213



Aksidente në trafikun rrugor	
Viti 2020	Viti 2021
13,868	21,275



Hyrje/dalje të personave në kufi	
Viti 2020	Viti 2021
11,348,216	20,079,046



Protesta dhe tubime të qytetarëve	
Viti 2020	Viti 2021
222	271



Refuzimi i hyrjes në Republikën e Kosovës	
Viti 2020	Viti 2021
3,082	7,436



Refuzimi i daljes nga Republika e Kosovës	
Viti 2020	Viti 2021
479	635

PARANDALIMI I PËRHAPJES SË VIRUSIT COVID-19

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, në përputhje me planin e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19, gjatë këtij viti, Policia e Kosovës ka hartuar 115 shtojca/anekse, bazuar në UO për gatishmëri dhe reagim kundër virus COVID-19, të cilat kishin për qëllim:

- a) Bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet qendrore dhe lokale, përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e rreziqeve nga korona virusi;
- b) Përgatitja paraprake e planeve operative policore për përballje me mjediset epidemiologjike;
- c) Krijimi dhe zhvillimi i kontakteve, bashkëpunimi dhe harmonizimi i veprimeve të përbashkëta me institucionet shëndetësore, agjencitë dhe institucionet tjera reaguese në parandalimin dhe luftimin e korona virusit;
- d) Ofrimin e mbështetjes në aspektin e sigurisë së agjencive dhe institucioneve të tjera shëndetësore dhe emergjente;
- e) Ngritja e vigjilencës policore për reagim të sigurt dhe efikas, gjithmonë duke i ndërmarrë masat fillimisht për siguri personale dhe të të tjerëve.

Për të siguruar koordinimin e aktiviteteve ndërinstytucionale në parandalimin e përhapjes së



virusit në Kosovë dhe njëkohësisht për të parandaluar përhapjen e virusit në kuadër të Policisë, Policia e Kosovës ka mbajtur aktive Qendrën Komanduese për Menaxhim të Operacionit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP) dhe në nivelin e Drejtorive Rajonale të Policisë (DRP) dhe njëkohësisht ka dërguar përfaqësuesin në:

- Komitetin për koordinim dhe vlerësim të situatës emergjente me virusin COVID-19, i themeluar nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe në
- Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në zbatimin e UO për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19 janë angazhuar gjithsej



6,500 zyrtarë policorë apo 80.11% e personelit të uniformuar të Policisë, të cilët kanë qenë të angazhuar në: a) patrullimin parandalues 24/7 fillimisht me 2 ndërtime, b) 167,821 pika të kontrollit; e) në inspektimin e 20,634 qytetarëve të cilët kanë qenë në vetizolim në shtëpi; f) 3,993 përcjellje policore; g) 5,046 asistime inspektorëve sanitarë/komunalë, si dhe h) 1,136 asistime të shërbimeve shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe raportuese në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në zbatimin e UO për mosveprim sipas dispozitave shëndetësore janë: a) janë shqiptuar 199,198 fletëparaqitje (tiketa) në bazë të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe b) janë shqiptuar 50,058 vërejtje nga Policia për qytetarët.



Gjatë kësaj periudhe raportuese janë shpërndarë: 37,396 maska mbrojtëse kundër virusit (15,571 maska kirurgjike dhe 21,825 maska shumëpërdorimëshe), 27,698 copë dezinfektues. Po ashtu, personeli i DShSh-së kanë zhvilluar një numër të aktiviteteve vetëdijësuese lidhur me parandalimin e përhapjes së virusit brenda Policisë, me ç'rast ka vendosur dhe shpërndarë posterët: “Kur të jetë radha jote vaksinohu”, “Ndalohet hyrja pa maska” dhe “Thuaj STOP kancerit të gjirit”.

Përkundër angazhimit të madh të Policisë në parandalimin e përhapjes së virusit, Policia ka qenë edhe vet e prekur nga ky virus. Kështu që gjatë vitit 2021 në vetizolim kanë qenë 1,589 punonjës të Policisë dhe janë infektuar 917 zyrtarë policorë me virusin COVID-19, ku 12 prej tyre kanë vdekur.



SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE

Me anë të një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët por edhe me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e sigurisë, Policia e Kosovës ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjes së objektivave policore, si rezultat i shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik në Kosovë.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 50,148 raste, prej të cilave 30,108 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 20,040 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, numri i rasteve ka shënuar ngritje për 23.03%, numri i veprave penale ka shënuar ngritje për 9.86% dhe numri i kundërvajtjeve dhe raste të natyrave të tjera, po ashtu kanë shënuar ngritje për 50.05%.

Rënie/ngritje më të dalluara janë vërejtur si në vijim:

- Numri i vrasjeve ka shënuar rënie, nga 29 në 27 ose rënie për 6.89%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar ngritje, nga 250 në 296, ose ngritje për 18.4%;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar ngritje, nga 3,863, në 4,333, ose ngritje për 12.16%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, nga 3,455 në 3,223, ose rënie për 6.71%;
- Numri i grabitjeve po ashtu ka shënuar ngritje, nga 148 në 158, ose ngritje për 6.75%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje, nga 2,069 në 2,432, ose ngritje për 17.54%.



Policia e Kosovës ka ndaluar 5,540 persona për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020 është shënuar një ngritje për 15.89%. Po ashtu, Policia ka arrestuar 15,428 persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e personave të arrestuar për 12.93%.

Në operacione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar 1,280 armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020 është shënuar një ngritje për 12.77%, si dhe janë konfiskuar 42,031 sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020 është shënuar një ngritje për 28.35%.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej 271 protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020 vërehet një ngritje e protestave dhe tubimeve për 22.07%.

Përveç angazhimit policor në përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2021, gjatë kësaj periudhe, Policia ka ofruar





mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe autoriteteve tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç'rast janë ofruar 9,114 asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e ofrimit të asistencës për 15.80%.

Përveç angazhimit në parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Republikën e Kosovës dhe vazhdimin e përmbushjes së të gjitha detyrave policore të parapara me Ligjin e Policisë dhe planin e

punës së Policisë për vitin 2021, Policia ka vazhduar të ofrojë siguri 24 orëshe në 123 pika statike të objekteve të rëndësisë së veçantë: diplomatike, qeveritare, policore, ministrore, prej të cilave 24 pika statike të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse. Ndërsa për të gjitha objektet tjera të rëndësisë së veçantë, Policia e Kosovës kujdeset me anë të patrullimeve të rregullta, ku në bazë të vlerësimeve ndërmerr edhe aktivitete tjera të nevojshme për sigurinë e këtyre objekteve.



SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shtetet e tjera. Për të adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi po bën përpjekje të mëdha që të ngritet siguria në trafikun rrugor duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë e cila në bërthamën e saj ka: i) parandalimin (me metodat proaktive dhe reaktive) dhe zbulimin e të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e përgjithshme të trafikut rrugor, (i.i.) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësive organizative të Policisë, pastaj ato ndërinstitucionale, ndërkombëtare, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor dhe (i.i.i.) orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka hartuar dhe ka zbatuar 15 plane operative në lidhje me ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor. Janë hartuar 150 raporte analitike dhe janë realizuar inspektime të infrastrukturës rrugore, të cilat kanë qenë të orientuara në identifikimin dhe adresimin e dukurive negative në trafikun rrugor, duke përfshirë fenomenologjinë dhe etiologjinë e aksidenteve. Ka hartuar 238 raporte/shkresa në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore, të cilat janë adresuar te institucionet përkatëse. Janë realizuar 89 takime dhe pjesëmarrje në 30 emisione radio/televizive dhe




49 fushata vetëdijesuese, të fokusuar në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

Në kuadër të angazhimit të Policisë në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë vitit 2021 Policia ka shqiptuar 484,138 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor, që në raport me vitin 2020 është shënuar ngritje për 88.74%.

Fatkeqësisht, edhe përkundër përpjekjeve të mëdha të Policisë dhe shtimit të numrit të tiktave për 88.74%, gjatë kësaj periudhe vërehet ngritje e:





- aksidenteve në trafikun rrugor, nga 13,868 në 21,275 aksidente, apo ngritje për 53.41%;
- aksidenteve me fatalitet, nga 76 në 99 aksidente, apo ngritje për 30.26%;
- aksidenteve me lëndime, nga 5,406 në 7,651 aksidente, apo ngritje për 41.52%;
- aksidenteve me dëme materiale, nga 8,386 në 13,525 aksidente, apo ngritje për 61.28%.
- 111 persona kanë humbur jetën, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020 shënon ngritje për 37.03%,
- 14,622 persona janë lënduar, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020 shënon ngritje për 42.75%.

Sa iu përket aktiviteteve të Komisionit për Vendosje, lidhur me kundërshtime të parashtruara për kundërvajtjet e shqiptuara nga ana e Policisë, gjatë këtij viti janë pranuar gjithsej 5,894 kundërshtime (ankesa), janë mbajtur gjithsej 439 seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe janë përpiluar gjithsej 5,271 vendime.

Në kuadër të angazhimeve në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 525 përcjellje të materieve të rrezikshme dhe 395 përcjellje të personaliteteve të rëndësishme, në përputhje me UO për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19.



¹ Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020, numri i tiketave të shqiptuara për kundërvajtje në trafikun rrugor ka shënuar ngritje për 88.74%. Por vlen të theksohet se përveç angazhimit në ofrimin e sigurisë së trafikun rrugor, njësitet e trafikun rrugor kanë qenë të angazhuara po ashtu edhe në luftimin dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Kosovë, me ç'rast së bashku me njësitet e tjera policore, kanë shqiptuar 199,198 fletëparaqitje (tiketa) në bazë të Ligjit COVID-19 dhe 50,058 vërejtje nga Policia për qytetarët.

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA, KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT, TERRORIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,613 raste, prej tyre 975 raste të reja, 422 raste të pranuar nga njësitë e tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, 216 raste janë bartur nga vitet paraprake. Sa i përket krahasimit të numrit të rasteve në punë me vitin 2020 nuk është shënuar ndonjë dallim.

Janë realizuar 571 operacione, që krahasuar me vitin 2020 tregon rënie për 0.2% dhe janë bastisur dhe kontrolluar 1,072 lokale, që në krahasim me vitin 2020 tregon ngritje për 13.4%;


Gjatë vitit 2021, janë arrestuar 1,356 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, që krahasuar me vitin 2020 tregon rënie për 8.13%, ndërsa përkohësisht janë ndaluar 732 persona, që krahasuar me vitin 2020 tregon ngritje për 52.2%.

Janë paraqitur 1,091 kallëzime penale, 66 prej të cilave me kryes të panjohur, 1,025 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 2,014 personave

që krahasuar me vitin 2020 kemi një ngritje të kallëzimeve penale për 3.9%. Janë goditur 49 grupe kriminale që krahasuar me vitin 2020 tregon ngritje për 75%.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë vitit 2021 janë regjistruar 131 raste, janë arrestuar gjithsej 182 persona të dyshuar dhe janë paraqitur 78 kallëzime penale ndaj 147 personave të dyshuar dhe 34 fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj 75 personave. Prej tyre, për: a) trafikim me njerëz - janë regjistruar 28 raste; b) mundësim prostitucioni - janë iniciuar 40 raste; c) marrje me prostitucion - janë regjistruar 33 raste dhe d) për vepra të tjera të kësaj natyre - janë regjistruar 30 raste. Janë identifikuar 43 viktima dhe janë asistuar 39 viktima të trafikimit. Në kuadër të kampanjës së vetëdijesimit kundër trafikimit me qenie njerëzore, Policia ka mbajtur një sërë takimesh me institucionet edukativo-arsimore si dhe institucionet shëndetësore. Po ashtu ka zbatuar Planin Operativ “Identifikimi i fëmijëve në situatë rruge si viktima të mundshme të trafikimit”. Gjatë zbatimit të këtij plani, ka rezultuar me identifikimin e 18 fëmijëve lëmshë - kërkues dhe identifikimi i





23 lëmoshë – kërkuesve të rritur.

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë janë iniciuar gjithsej 726 raste të reja, janë arrestuar 792 persona dhe janë paraqitur 541 kallëzime penale ndaj 738 të dyshuarve. Prej tyre, për: a) trafikim- janë regjistruar 218 raste, b) posedim të drogave - 478 raste, c) kultivim 29 raste, dhe 1 rast është iniciuar për droga të tjera. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar 15 raste; për kokainë janë regjistruar 64 raste, për mariuhanë janë iniciuar 577 raste, për kultivimin e bimëve të kanabisit janë iniciuar 29 raste ndërsa për droga të tjera janë regjistruar 29 raste.

Gjatë vitit 2021 janë konfiskuar: 3 kg. 642.31 gr. heroinë; 414 kg 958.18 gr. kokainë; 499 kg 549 gr. mariuhanë, 2,380 bimë kanabis.

Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë janë regjistruar 339 raste, janë arrestuar 260 të dyshuar dhe janë paraqitur 300 kallëzime penale ndaj 736 personave të dyshuar. Për veprën penale: a) kundër detyrës zyrtare/ korrupsionit- janë regjistruar 178 raste; b) kundër ekonomisë - 82 raste; c) kundër pasurisë- 23 raste; d) fajde - 1 rast; e) shpëlarje të parave- 3 raste dhe

2 raste të tjera; e) vepra të tjera lidhur me falsifikim dhe mashtrim, janë regjistruar 49 raste dhe f) për korrupsion lidhur me votat është regjistruar 1 rast.

Në fushën e hetimit të krimeve të rënda, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 128 raste. Janë arrestuar 15 persona të dyshuar dhe janë paraqitur gjithsej 44 kallëzime penale ndaj 197 personave të dyshuar. Policia në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore, ka trajtuar 3 raste të gjetjeve eshtërore dhe në 2 lokacione ka vazhduar me procedurat për



eksumimin, zhvarrimin, autopsinë dhe identifikimin e eshtrave. Janë trajtuar 2 informata lidhur me identifikimin e krimeve të luftës.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit - Policia e Kosovës vazhdon të adresojë në mënyrë strategjike, duke filluar prej bashkëpunimit në nivel lokal përmes Këshillave Komunale për Sigurinë Bashkësi (KKS), Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP), e deri te implementimi i strategjisë shtetërore kundër terrorizmit dhe planit të veprimit 2018-2023 dhe strategjisë kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023, si dhe në përputhje me doracakun e Policisë së Kosovës “Qasja proaktive policore - roli i policimit në bashkësi në identifikimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm”.

Gjatë vitit 2021 janë trajtuar gjithsej 35 raste, prej tyre 13 raste të reja dhe 22 raste të bartura. Janë arrestuar 14 persona, si dhe janë paraqitur 14 kallëzime penale kundër 17 personave.

Po ashtu, gjatë këtij viti janë realizuar 2 plane operative:

- “Kthimi II”- ky plan është realizuar duke kthyer nga zona e konfliktit 11 persona kosovar, prej të cilëve 6 burra, 1 grua dhe 4 fëmijë ,dhe
- “Refugjati “ cili u realizua në bashkëpunim me



zyrtar nga MPB-ja dhe institucione të tjera, të cilët kanë pranuar dhe trajtuar rreth 1,300 persona nga Afganistani. Këta persona kanë hyrë në Republikën e Kosovës, pastaj në mënyrë të organizuar, shumica nga ta kanë udhëtuar në vende tjera ndërsa rreth 500 nga ta, qëndrojnë ende në Kosovë.

Në fushën e hetimit të krimit të organizuar, gjatë kësaj periudhe janë iniciuar 57 raste, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 tregojnë rënie për 13.63%. Janë realizuar 31 operacione, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 tregojnë rënie për 24.39%. Janë paraqitur 43 kallëzime penale ndaj 172 personave, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 tregojnë rënie për 6.52% e kallëzimeve penale, ndërsa ngritje për 7.50% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.



KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Policia e Kosovës ka treguar një përkushtim të veçantë edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK). Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve, autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar: 20,079,046 persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregojnë ngritje për 76.93%; 7,104,175 mjete motorike, që tregojnë ngritje për 59.97% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa rënie për 100% e trenave.

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar 3,875 persona të rëndësishëm.

Sa i përket kontrollit të vijës së dytë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje me parimet e MIK-ut, kanë arritur që të kontrollojnë:

Tabela nr. 1: Kontrolli i vijës së dytë.

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	%
Persona	35,197	53,541	52.11
Automjete	21,282	39,718	86.62
Dokumente	7,625	14,716	92.99



Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 873 raste të veprave penale, 382 kundërvajtje, kanë shqiptuar 1,213 gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve. Policia Kufitare ka arrestuar: a) 970 persona për vepra të ndryshme kriminale; b) 1,407 persona me urdhëresa vendore; c) 2 persona me urdhëresa të ndryshme (ndërkombëtare etj.) dhe ka ndaluar 185 persona.

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë 720 inspektime në fushën e migrimit të të huajve, 7,436 refuzime të hyrjes, 635 refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar 810 verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar 37 depërtime, 52 urdhër largime me forcë, 109 urdhër largime vullnetare dhe kanë trajtuar 578 kërkesa për azilkërkues.

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar 118 operacione dhe 269 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: 84 takime të punës brenda Policisë, 152 takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa 55 aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.

NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE

Policia e Kosovës punëson 9,079 punonjës, prej të cilëve 8,113 janë zyrtarë policorë dhe 966 staf civil. Nga ky numër 85.04% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, kurse 14.96% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.82% janë shqiptarë dhe 15.18% iu takojnë komuniteteve tjera.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm të saj, Policia e

Kosovës në vazhdimësi investon në kuadrat e saj, duke filluar me rekrutimin e gjeneratave të reja të policëve, ofrimin e njohurive bashkëkohore në fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e sistemeve të bazës së të dhënave, të nevojshme për kryerjen sa më efektive dhe efikase të punës policore, furnizimin me të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrave policore, renovimin/sanimin dhe rregullimin e infrastrukturës së objekteve të Policisë, si dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së zyrtarëve të saj.

Gjatë këtij viti, gjenerata e 56-të me 197 kadetë ka mbaruar trajnimin themelor për policinë e përgjithshme dhe ka vazhduar me trajnimin praktik-fushor.

Po ashtu, gjatë këtij viti për herë të parë është bërë implementimi i modulit të rekrutimit për zyrtarë policorë ku është realizuar aplikimi online në konkursin për zyrtarë policorë, në të cilin kanë aplikuar 11,843 kandidatë.

Për angazhimin e dalluar të pjesëtarëve të Policisë janë ndarë: 1,737 medalje për Shërbim të Besnikërisë, 3 medalje për Shpëtim Jete, 25 medalje për Lëvdim, 23 Lëvdata dhe 17 Mirënjohje nga drejtori i përgjithshëm.

Pandemia e COVID-19 ndikoi në çdo aspekt të përmbushjes së detyrave të Policisë, duke përfshirë edhe përpjekjet e saj për të rekrutuar, punësuar dhe trajnuar zyrtarët e Policisë. Duke respektuar masat parandaluese për parandalimin e pandemisë që kufizonte numrin e pjesëmarrësve në trajnime sipas



udhëzimeve të shëndetit publik, gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Trajnimeve arriti të organizojë dhe administrojë gjithsej 1,500 trajnime online dhe me prani fizike, që krahasuar me vitin 2020 tregon ngritje për 370.21%. Në përgjithësi janë realizuar: 600 trajnime për 14,914 pjesëtarë të saj dhe 278 ricertifikime për 3,006 zyrtarë policorë. Në bashkëpunim me organizata të tjera janë organizuar 505 trajnime për 4,116 pjesëtarë të saj. Ndërsa, jashtë

vendit janë organizuar 103 aktivitete (trajnime, takime, konferenca) për 303 zyrtarë policorë. Gjatë kësaj periudhe Divizioni i Trajnimeve ka organizuar 14 trajnime për organizatat tjera, në të cilat kanë marrë pjesë 112 pjesëmarrës.

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2021, ka në dispozicion buxhetin prej 109,351,927.45€. Për paga të punonjësve të Policisë janë shfrytëzuar shuma prej 84,306,652.64€, ndërsa shuma e përgjithshme e të hyrave për këtë periudhë kohore ka qenë 16,712,402.08€. Brenda kësaj periudhe janë iniciuar 157 projekte të prokurimit, prej të cilëve 124 kanë qenë për furnizim, 17 për shërbim, ndërsa 16 për punë.

Për të siguruar një qasje profesionale në zbatim të ligjit, Policia e Kosovës monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj. Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës ka administruar 1,455 lëndë disiplinore, prej tyre 694 lëndë të hapura gjatë vitit 2021 dhe 761 lëndë të bartura nga vitet paraprake. Nga gjithsej 761 lëndë të bartura janë përfunduar 503 lëndë apo 66% e tyre.

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 1,023, prej tyre 503 lëndë kanë qenë nga vitet paraprake, ndërsa 520 lëndë nga viti 2021. Nga gjithsej 1,023 lëndë të përfunduara, 422 lëndë kanë qenë me status të bazuar, 483 me status të paargumentuar, për 26 lëndë nuk ka veprim, për 53 lëndë kanë pushuar hetimet,



2 lëndë janë kthyer në Inspektoratin e Policisë së Kosovës, ndërsa 4 lëndë janë rekomanduar në nivel lokal.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor janë pranuar 413 lëndë dhe janë shqyrtuar 473 lëndë. Janë nxjerrë 539 vendime disiplinore, nga të cilët: 45 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; 1 rast degradim; 1 rast largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi më të ulët menaxhuese por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale; 313 raste ndalesë në pagë mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj; 15 transfere; 23 raste ndalesë në pagë 5% deri në 20% të pagës mujore bruto deri në dy muaj; 105 vërejtje me shkrim; 32 vërejtje me gojë; 4 raste është përgjegjës për shkelje disiplinore dhe lirohet nga shqiptimi i masës disiplinore.

Nga gjithsej 1,197 raste të cilat janë pranuar gjatë vitit 2021 dhe 32 raste që kanë qenë të bartura nga viti paraprak, Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar 1,191 raste, prej të cilave: në 754 raste është konstatuar se ankesa ka qenë e pabazuar dhe vendimi mbetet në fuqi; në 221 raste ankesa ka qenë e bazuar dhe e aprovuar; në 88 raste ankesa ka qenë pjesërisht e bazuar dhe vendimi ka qenë pjesërisht i ndryshuar; në 89 raste vendimi është kthyer në plotësim të hetimeve, ndërsa në 39 raste ankesa është hedhur poshtë sepse është parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesi, i pabazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i kësaj kontrole, gjatë periudhës raportuese, Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar 11 auditime të rregullta, për të cilat janë dhënë 60 rekomandime. Këto auditime janë bërë në fusha të

ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e Policisë.

Në kuadër të inspektimeve të brendshme, Policia ka realizuar 53 inspektime të rregullta si dhe 70 inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së Policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë 184 rekomandime. Shëndeti i personelit policor ka qenë në fokus të vazhdueshëm të organizatës. Me qëllim që të identifikohen, adresohen dhe parandalohen sëmundjet dhe dukuritë tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore ka përgatitur Projektin “Kontrollimi Sistematik Mjekësor dhe Psikologjik i personelit Policor të Policisë së Kosovës”, që ka filluar të realizohet në Qershor të vitit 2021.

Gjatë kësaj periudhe ekipi mjekësor dhe Ekipi për Këshillim dhe Përkrahje i DShSh-së në kuadër të Policisë kanë organizuar testimin sistematik psikologjik për personelin policor, në të cilin kanë marrë pjesë 659 pjesëtarë të Policisë, ndërsa janë realizuar 329 kontrollime sistematike për zyrtarë policor, të grup moshës 60-64 vjeçar. Policia e Kosovës, ka mbështet fushatën e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut me 1,075 dhurues vullnetarë të gjakut. Sa i përket vaksinimit kundër virusit Covid-19, brenda kësaj periudhe kohore, janë vaksinuar 8,909 pjesëtarë të Policisë, të cilët kanë aplikuar për termin të vaksinimit, nëpërmes platformës eKosova.

Përveç angazhimit në parandalimin dhe luftimin e përhapjes së COVID-19 brenda Policisë, personeli i

Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore (DShSh) në kuadër të Policisë ka qenë po ashtu i angazhuar në:

- a) ofrim të përkrahjes shëndetësore ndaj zyrtarëve policorë me risk të lartë ndaj COVID-19;
- b) ofrim të përkrahjes psikologjike në menaxhimin e ankthit dhe panikut tek personeli policor, me ç'rast gjatë vitit 2021 janë mbajtur 245 seanca psikologjike dhe 122 vlerësime psikologjike;
- c) ofrim të përkrahjes mjekësore për 6,254 pjesëtarë të Policisë;
- d) fushatën e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGj), në të cilën kanë marrë pjesë 1,075 punonjës të Policisë.

Policia e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar zhvillimit të modernizimit të teknologjisë informative si dhe zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në përputhje me planin Strategjik të Zhvillimit për 2016-2021. Në kuadër të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) janë vazhduar aktivitete të orientuara në ofrimin e qëndrueshmërisë: a) Sistemi i Integruar Informativ i Policisë (SIPK); b) Sistemi Informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS); c) Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve (BIMS); d) Sistemi i vëzhgimit përmes kamerave në objektet policore; e) Projekti 3D-GIS; f) Implementimi i sistemit të ri për linjat emergjente 192; g) Përmirësimi i Sistemit Telefonik VoIP; Policia e Kosovës ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjithashtu ka mbështetur dhe ka promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, me theks të veçantë në fushën e sigurisë rrugore, armëmbajtjes pa leje, përdorimit të dhunës etj. Gjatë periudhës raportuese në nivel qendror dhe lokal të Policisë:

- a) janë lëshuar 1,633 komunikata me shkrim për media;
- b) janë publikuar 365 raporte 24-orëshe;
- c) janë publikuar 1,619 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë;
- d) janë dizajnuar dhe janë publikuar 86 projekte policore;

e) është hartuar dhe është publikuar revista e Policisë së Kosovës “MBROJTËSI” dhe

f) janë publikuar spote televizive, broshura vetëdijesuese lidhur me parandalimin e veprave penale si dhe aksidentet në trafik si çështje me rëndësi në krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt.

Duke marrë në konsideratë faktin se Policia e Kosovës udhëhiqet nga parimi i policimit demokratik dhe si rrjedhojë e kësaj transparence para shoqërisë dhe publikut në përgjithësi është esenciale për funksionimin e Policisë, gjatë këtij viti faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në rrjetin social ‘Facebook’ <https://facebook.com/Kosovopolice/> ka pasur gjithsej 130,5 mijë ndjekës aktivë.

Ndër më të shikuarat në faqen zyrtare të Policisë së Kosovës në Facebook dhe Twitter, kanë qenë postimet që kanë të bëjnë me shërbimin ndaj qytetarëve, që ndërliohen me sigurinë rrugore, publikime të ndryshme të natyrave të ndryshme për vitin 2021. Duke u bazuar në numrin e shikueshmërisë del se lajmi i datës 14 dhjetor 2021 “Identifikohet dhe ndëshkohet personi i cili ka përdorur drita rotative në automjetin e tij” ka shënuar numrin prej 639,2 mijë shikimeve, njoftimi për konkursin për policë të rinj ka shënuar 311 mijë shikime, pastaj kërkesa për bashkëpunim në identifikimin e një të dyshuari për ‘vrasje të rëndë’ ka shënuar 267,3 mijë shikime. Faqja zyrtare e Policisë në Facebook është renditur e para për nga shikimet, gjithashtu është e pëlqyer me mbi 65.1K në këtë vit, krahasuar me vitin paraprak i cili ka qenë rreth 64 K.

Finalizimi i këtij raporti nuk kishte qenë i mundur pa ndihmën, bashkëpunimin dhe përkrahjen e Departamenteve-Drejtorive përkatëse. Prandaj, me këtë rast shprehim mirënjohjen dhe falënderimin më të lartë për bashkëpunimin e vazhdueshëm të:

Departamenti i Operacioneve - Toger Lulzim Borovci;
Departamenti i Hetimeve - Kapiten Bajram Nuhiu;
Departamenti për Kufi - Toger Faik Behrami dhe Polic Arbias Bunjaku;
Departamenti për Burime Njerëzore - SC Kysmete Shtanaj dhe SC Florie Berisha; dhe
Departamenti për Shërbime Mbështetëse - SC Adile Ramadani.



POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE

PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL APLIKACIONI ‘LAJMËRO POLICINË’

MUNDËSI AL-
TERNATIVE E
KOMUNIKIMIT TË
QYTETARIT ME
POLICINË PËR
LAJMËRIMIN E
RASTEVE

GARANTIM
ANONIMITETI
DHE REAGIM
I SHPEJTË

APLIKACIONI
“LAJMËRO POLICINË”
ËSHTË PLATFORMË
ELEKTRONIKE

MUNDËSI
E DËRGIMIT
TË TEKSTEVE,
FOTOVE
DHE VIDEOVE

RAPORTO
NË 24 ORË



BASHKËPUNIM,
PARTNERITET,
TRANSPARENCË